



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA GRAMSH  
KRYETARI KËSHILLIT

Nr. 1518/ Prot

Gramsh më, 27.05.2021

VENDIM

Nr. 55 dt. 30/04/2021

Për

**“Miratimin e vlerës financiare të dëmeve të shkaktuara nga tërmeti në banesën e z. Xhelal Xhelili, banor në fshatin Mazrekë, Njësia Administrative Sult, si dhe dëmshpërblimin financiar”.**

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës \_\_.04.2021, pasi shqyrtoi relacionin dhe dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, sektori i Emergjencave Civile dhe “Për miratimin e vlerës financiare, të dëmeve shkaktuar nga tërmeti në banesën e shtetasit Z. Xhelal Xhelili, banor në Fshatin Mazrekë, Njësia Administrative Sult, si dhe dëmshpërblimin financiar”, bazuar në:

- Ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligjin 45/2019 “Për mbrojtjen civile”;
- VKM nr.329 datë 16.5.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera, të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”;

VENDOSI:

1. Miratimin e dokumentacionit tekniko-ligjor të hartuar nga specialistët e Bashkisë Gramsh.
2. Të miratojë vlerën e dëmshpërblimit financiar bazuar në V.K.M. Nr. 329 datë 16.5.2012 e cila është 50% të vlerës së preventivit të përlogaritur bazuar në dëmet e shkaktuara nga tërmeti në banesë, d.m.th.  $517\ 141 \times 50\% = 258\ 571$  lekë, pra vlera e dëmshpërblimit për shtetasin Z. Xhelal Xhelili është në 258 571 (dyqind e pesëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e një) lekë.
3. Ti paraqesë dokumentacionin përkatës dhe ti kërkojë mbështetje financiare Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, Ministrisë së Mbrojtjes, për akordimin e dëmshpërblimit prej 258 571 (dyqind e pesëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e një)lekë, për shtetasin Z. Xhelal Xhelili.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Publike ( Sektori I Emergjencave Civile ).

Sekretari i Këshillit të Bashkisë

XHULIA GJINI

Konceptoi: Xh. Gjini  
Pranoi: G. Lena  
Miratoi: G. Lena  
Dosja nr: \_\_\_\_\_



KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

GRETA LENA